



F T E S Ę

SAMITI I DYTĚ

NDĚRKOMBĚTAR I ARSIMTARĚVE LIDERĚ

TEMA:

[Arsimi Multikulturor dhe Eksperienat Multikulturore në Arsim /

Cross-cultural Education and Multicultural Experiences in Education]

15 - 17 Korrik 2016 – Shkup, Maqedoni

Krijimi dhe mundësimi i paqes dhe stabilitetit në Turqi dhe në shtetet rajonale do të realizohet nën udhërrëfimin dhe udhëzimin e arsimtarëve dhe mësimeve. Samiti Ndërkombëtar i Arsimtarëve Lider do të organizohet në pikënisje të këtij mendimi. Tema kryesore e samitit, i cili organizohet një herë në dy vjet është përcaktuar në formën 'Arsimi Multikulturor dhe Eksperienat Multikulturore në Arsim'.

Mësuesit dhe arsimtarët i ftojme në Samitin që do të organizohet në Maqedoni. Edhe ju mund të jepni kontributin tuaj në Samit me raportet e arsimit mbi shtetet, kumtesat në formë fjale apo shkrimi, punë-praktikat dhe në propozimet tuaja për kongresin e diskutimeve, mund të ndaj informacionet, aftësitë, mendimet dhe eksperienat tuaja.

Gjendemi në një atmosferë të mungesës së qetësisë dhe të kaosit, e cila shtohet çdo ditë e më shumë në rajonin tonë dhe në botë. Udhë dhe mënyra e përhapjes së paqes dhe harmonisë si arsimtarë kalon nga gjetja e gjuhës së përbashkët së pari mes nesh. E dimë se kjo gjuhë gjendet në eksperienat tona historike dhe akumulimet lokale. Takohemi dhe bashkohemi për të nxjerrë në pah këtë thesar, për të krahasuar eksperienat tona bashkëkohore, për të pasuruar vullnetin tonë për të jetuar bashkarisht, për të lartësuar motivimin tonë dhe për të zhvilluar metoda dhe teknika për bartjen e këtyre përfitimeve brenda klasës. Synimi ynë është të forcojmë shpresën për paqe dhe harmoni në vendet tona, rajonin tonë dhe në botë me anë të studentëve dhe prindërve tanë.

FUSHAT E PROPOZUARA PËR APLIKIM:

- Prezantim i Raportit mbi Arsimin në Vendin tuaj: Propozim në lidhje me raportin "Eksperienca Multikulturore" në vendin tuaj.
- Prezantim Kumtese: Propozim kumtese në formë fjale apo shkrimi në përputhje me temën kryesore.
- Zbatimi i punë-praktikës: Propozim për zbatimin e punë-praktikës në përputhje me temën kryesore në një kohë maksimale prej një ore.
- Kongresi i konsultimeve: Propozim për konsultimin dhe diskutimin e një teme në përputhje me temën kryesore.



SHEMBUJ TE SUGJERIMEVE

Raport rreth arsimit në vendin tuaj:

- Do të prezantohen raportet mbi praktikimet nëpër shtetet në kuadër të temës 'Arsimi Multikulturor dhe Eksperienat Multikulturore në Arsimit'.

Shembuj temash për kumtesat:

- Arsim komparativ multikulturor
- Arsimit dhe harmonia shoqërore
- Roli i arsimit në shndërrimin e dallimeve shoqërore në pasuri
- Edukimi dhe të drejtat themelore të njeriut
- Marrëdhëniet shkollë – shoqëri dhe roli i OJQ-ve
- Politikat e formimit të arsimtarëve në pikëpamje të kontributit në harmoninë shoqërore
- Media, paqja dhe arsimit
- Shembuj dhe praktika të mira për harmoninë shoqërore brenda klasës dhe shkollës
- Pasqyrimet e mediave sociale mbi multikulturalizmin
- Praktikime dhe zbatime që kontribuojnë në multikulturalizmin në formatet dixhitale
- Shembuj të aplikimit të arsimit multikulturor në vende të ndryshme
- Multikulturalizmi në programet mësimore
- Arsimit dhe lëvizja ndërkombëtare
- Arsimit dhe dukuria e emigrimit
- Praktikime projektesh në arsim
- Formimi i rrjeteve globale në arsim, e sotmja dhe e nesërmja

Shembuj nga temat e punë-praktikës:

- Praktika edukative në zhvillimin e lirive individuale
- Aktivitete arsimore brenda klasës të fokusuar në paqen dhe harmoninë shoqërore
- Praktikime dhe zbatime arsimore për një brez paqësor me veten dhe shoqërinë
- Projektimi i dhomave të mësuesve multikulturorë
- Aktivitete brenda klasës të fokusuar në tolerancë
- Aktivitete brenda klasës të fokusuar në drejtësi
- Aktivitete brenda klasës të fokusuar në barazi
- Aktivitete brenda klasës të fokusuar në respekt
- Aktivitete brenda klasës të fokusuar në dhembshuri
- Shembuj praktikimesh dhe zbatimesh që japin kontribut ndaj multikulturalizmit me anë të medias sociale, faqeve të internetit dhe praktikimeve mobile.

Temat e konsultimit në kongresin diskutimor:

- Arsimit mbi paqen dhe shkolla
- Praktikimet e arsimit multikulturor
- Programet edukative dhe arsimit multikulturor
- Librat shkollorë dhe arsimit multikulturor



KORNIZA E SAMITIT

- Gjuha e “Samitit Ndërkombëtar të Arsimitarëve Lider” është turqisht dhe anglisht.
- Samiti do të përbëhet nga prezantimi i raporteve të shteteve, prezantimi i kumtesave, punë-praktika dhe nga sesionet e kongresit diskutimor.
- Pjesëmarrësit që do të dërgojnë propozim mbi kongresin diskutimor janë të detyruar të aplikojnë në të paktën edhe një fushë tjetër (prezantim i raporteve të shteteve, prezantim i kumtesave, punë-praktika).
- Aplikimet do të bëhen nga faqja jonë e internetit online ose me anë të organizatave partnere nga shtetet pjesëmarrës.
- Kongreset diskutimore, të cilët do të organizohen në ditën e tretë të samitit, do të jenë të mbyllur për pjesëmarrjen e dëgjuesve.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Çdo arsimtar që ka punuar ose punon në ndonjë institucion arsimor të Turqisë apo vendeve të rajonit si dhe akademikët, personat që kanë përfunduar studimet universitare, studentë të nivelit master dhe doktoraturë.

Pritet që pjesëmarrësit të zotërojnë aftësinë e të folurit dhe të kuptimit të gjuhës turke dhe angleze.

SI MUND TË APLIKOJ?

- Përgatisni CV-në tuaj dhe sugjerimet për punë-praktikën, trajnimet profesionale dhe simpoziumin.
- Aplikimin dërgojeni në linkun e mëposhtëm deri në datën e fundit të aplikimit: 7 maj 2016
<http://ilts.oncuegitimciler.org.tr>

UDHËTIMI DHE AKOMODIMI

Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për pjesëmarrësit që do të dërgojnë aplikime nga jashtë Turqisë dhe Maqedonisë do të mbulohen nga Shoqata “Öncü Eğitimciler” dhe partnerët e saj.

DATA TË RËNDËSISHME

- Pranimi i aplikimeve për punë praktike, trajnimin dhe simpoziumin: 7 Maj 2016
- Njoftimi i aplikimeve të pranuar dhe shpallja e programit: 21 Maj 2016
- Pranimi i teksteve të plota të sugjerimeve: 11 Qershor 2016
- Datat e samitit: 15-17 Korrik 2016